



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE
SHKOLLA E MESME E AGROBIZNESIT "IRAKLI TEROVA" KORÇË
Nr 177 prot Korçë më 26.10.2021

Lënda: Njoftim për levizje paralele

Drejtuar : Agjencisë Kombetare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhezimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme e Agrobiznesit "IRAKLI TEROVA " Korçë
Ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin :

Mësimdhënës me kohë të plotë "LENDET VETERINARE"

Pozicioni : MESUES I LENDEVE të Teorise VETERINARE

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë Kriteret e përgjithshme PER LEVIZJET
PARALELE si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë Kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë Përkatese niveli Master profesional në fushën e Veterinarisë ose të barazvlefshëm me të njëjten fushë me njerin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP.
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lire , duhet të përfshijë :

- a) **letër motivimi për pozicionin;**
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 të këtij udhezimi
- c) kartën e identitetit,
- d) diplomën
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi.
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të tyre të noterizuara.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara. Dokumentat e aplikimit dorezohen në protokollin e ofruesit të AFP-së shkollë e mesme e "Agrobiznesit" IRAKLI TEROVA " brenda datës ...11.11.2021.

SHKOLLË E MESME E "AGROBIZNESIT"
DREKTORI I SHKOLLËS
(ADRIAN SHEREMENI)

e-mail: shkollaagrobiznes@yahoo.com

tel. 082242957